



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI PORTUAL DURRËS

**KRITERET E VECANTA PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “*Cloud mail server*”

**VLERA E FONDIT LIMIT: 5.000.000 (Pese milion ), lekë pa TVSH.**

**1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**1.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2020-2021-2022), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

**2. Kapaciteti teknik:**

**2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % nga vlera e përlogaritur e fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

**2.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas:

- ISO 9001:2015 për menaxhimin e cilësisë; ose ekuivalente
- ISO/IEC 20000-1:2011 për menaxhimin e shërbimeve; ose ekuivalente
- ISO 27001:2013 për menaxhimin e sigurisë së informacionit ; ose ekuivalente

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

**2.3** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën **2 (dy)** punonjës të certifikuar për zgjidhjen që do të ofrohet. Punonjësit duhet të jenë të kombinuar si më poshtë:

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në PMP/Prince2 ose ekuivalent në nivelin profesional për manaxhimin e projekteve.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për platformat Microsoft (Microsoft 365, Server, Azure, etc.)

Për secilin prej tyre të dorëzohen certifikatat përkatëse. Certifikatat të cilave u ka kaluar afati i vlefshmërisë janë objekt skualifikimi.

***Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.***

**2.4** Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi i licensave të kërkuara për shitjen dhe suportin për territorin e Republikës së Shqipërisë (të dorëzojë MAF përkatës). Autorizimi duhet të jetë i dedikuar për objektin e prokurimit dhe të përmbajë kontaktet e nevojshme (emër, email, telefon) për të verifikuar autenticitetin e tij.

**2.5** Punonjësit e certifikuar duhet të garantohen që do të dedikohen për objektin e këtij prokurimi pranë Autoritetit Kontraktor dhe Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që i ka të punësuar prej një periudhe të paktën 6 mujore nga data e dorëzimit të ofertës duke paraqitur kontratat e punësimit dhe vërtetimet përkatëse për pagesën e kontributeve të sigurimeve për secilin prej punonjësve.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**